



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 227, datë 9.4.2024

PËR

**ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË  
PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 6, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (në vijim AMVV) është institucion publik qendror, person juridik, me seli në Tiranë dhe në varësi të ministrit përgjegjës për pushtetin vendor (në vijim ministri).
2. AMVV-ja ka këto detyra dhe përgjegjësi:
  - a) Mbështet ministrinë në përgatitjen e mendimeve për projektakte ose dokument tjetër, që kanë të bëjnë me çështje që lidhen me njësitë e vetëqeverisjes vendore ose decentralizimin;
  - b) Monitoron zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe planin përkatës të veprimit;
  - c) Informon periodikisht institucionet publike, grupet e interesit dhe qytetarët për çështjet që lidhen me vetëqeverisjen vendore;
  - ç) Siguron informacione lidhur me çështjet e vetëqeverisjes vendore, me qëllim koordinimin e institucioneve publike qendrore dhe vendore për zgjidhjen e problematikave të ndryshme, si dhe harton raporte e analiza periodike për këto çështje;

- d) Ofron këshillim ligjor ose teknik për njësitë e vetëqeverisjes vendore, vetëm ose në bashkëpunim me struktura të tjera, për ushtrimin ose përmirësimin e punës në ushtrimin e funksioneve të tyre;
- dh) Mbledh të dhëna prej njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe të institucioneve qendrore për çdo tregues, që lidhet me performancën e njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe kontribuon në matjen e performancës së njësive të vetëqeverisjes vendore. Bazuar në të dhënat e mbledhura, sipas parashikimeve të kësaj pike, harton Raportin Vjetor Kombëtar, që përfshin analizën tërësore të të gjitha të dhënave dhe rekomandon masa për njësitë e vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e dhënies së shërbimeve;
- e) Bashkërendon proceset e punës, ndërmerr masa dhe koordinon iniciativat kombëtare me institucione të tjera për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- ë) Evidenton, dokumenton, promovon praktika të mira të vetëqeverisjes vendore dhe i paraqet modele rekomanduese bashkive për ushtrimin e kompetencave të tyre;
- f) Shërben si institucion ndërlidhës për bashkërendimin e punës së ministrisë përgjegjëse për pushtetin vendor me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendorë;
- g) Koordinon dhe monitoron zbatimin e masave, që rrjedhin nga procesi i integritit evropian ose marrëveshjet ndërkombëtare, për aq sa ato kanë të bëjnë me vetëqeverisjen vendore;
- gj) Mbështet ministrinë përgjegjëse për çështjet vendore për krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik për monitorimin dhe zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore;
- h) Kryen detyrat e Sekretariati Teknik të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, sipas legjislacionit në fuqi;
- i) Miraton dhe publikon raportin vjetor të veprimtarisë së AMVV-së dhe raporton te ministri sa herë që i kërkohet për veprimtarinë e saj;
- j) Ushtron funksione e veprimtari të tjera që i ngarkohen në përputhje me ligjin, marrëveshjet ndërkombëtare, vendimet e Këshillit të Ministrave dhe urdhrat e Kryeministrit apo të ministrit, që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen vendore.

3. AMVV-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme.
4. AMVV-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon, drejton dhe përgjigjet për veprimtarinë e saj.
5. Drejtori i Përgjithshëm i AMVV-së emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të ministrit përgjegjës për pushtetin vendor.



6. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AMVV-së rregullohen me Kodin e Punës. Ata emërohen, lirohen ose shkarkohen nga drejtori i Përgjithshëm i AMVV-së.
7. Organika dhe struktura e AMVV-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
8. Deri në miratimin e strukturës dhe organikës, sipas këtij vendimi, AMVV-ja do të funksionojë sipas strukturës dhe organikës në fuqi. Punonjësit e AMVV-së do të vazhdojnë të kryejnë funksionet, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.
9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga miratimi i strukturës dhe organikës të AMVV-së, ministri miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.
10. Vendimi nr.83, datë 28.1.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”, të ndryshuar, shfuqizohet.
11. Ngarkohen ministri përgjegjës për çështjet vendore dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

Në mungesë dhe me porosi

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

MINISTRI I SHTETIT PËR  
PUSHTETIN VENDOR

**ARBJAN MAZNIKU**

NR.PROT.276/7  
DATE 9.4.2024

MINISTRIT TË SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES  
VENDORE  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**



*Engjëll Agaçi*